45	6029007	Shpenzime për konferenca, ceremoni etj.	3,842,400				4,742,800	8,585,200	
46	6029008	Sh. tatim dhe taksa				100,000		100,000	
47	6029099	Shpenzime për qeverisjen studentore							
48	6029099	Sh. të tjera materiale dhe shërbime operative					960,000	960,000	
		TOTALI 602 (me tvsh)	5,022,604	0	9,060,276	29,856,028	43,938,908		
		LLOGARIA E SHPENZIMEVE (604, 606) Kapitull 6							
49	6040005	Te tjera transferime					503,200	503,200	
50	6053100	Transferime korrente për institucionet jo-fitimpruresë të huaja					105,000	105,000	
51	6061099	Te tjera transferata tek individët							
		TOTALI (604, 606)	0	0	0	608,200	608,200		
		BURSAT (6061021) Kapitull 8							
52	6061021	Bursat							
		TOTALI BURSAT (6061021)	0	0	0	0	0		
		INVESTIMET (LLOG.230/231) Kapitull 6							
53	230	Hartimi i projektit për mbrojtjen nga zjarri			120,000			120,000	
54	230	Detyrë projektimi, Projekt preventiv për ndërtimin e ri (shtesë anësore ose e shkeputur)(m							
55	230	Detyrë projektimi, Projekt preventiv për ndërtimin kabine elektrike							
56	230	Projekt për shtesë fuqie të rrymës elektrike të fshmit dhe fm							
57	230	Studim, projektim për rikonstruksionin e ambjentëve					6,800,000	6,800,000	
58	230	Projekti "Sistemi i Menaxhimit të personalizuar të UMT-së"			5,000,000			5,000,000	





TRANSFERIMET E BRENDSHME

KAPITULL (06)

Artikull 604

Nr.	NJËSITË SHPENZUESE	Parashikim 2020
1	Fakulteti i Mjekësisë	16,333,668
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	7,946,310
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	1,779,400
4	Njesia kryesore UMT-ë	-
TOTALI		26,059,378

Sqarim: Kjo tabelë përmban të dhënat për derdhjen e 10% në Njësinë Qëndrore të UMT-së.



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

TABELA E BURSAVE

KAPITULL (08)
Artikull 606

Nr.	NJËSITË SHPENZUESE	Kërkesa për bursa	SHPËRNDARJA		
			Grant i trashëguar 31.12.2019	Granti i akorduar Janr 2020	TOTAL
1	Fakulteti i Mjekësisë	61,650,000	16,280,000	55,012,079	71,292,079
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	47,800,000	18,915,246	42,653,323	61,568,569
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	25,000,000	4,421,100	22,308,223	26,729,323
TOTALI		134,450,000	39,616,346	119,973,625	159,589,971



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

TABELA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TË HUAJA 2020

Nr	EMRI I DONAT ORIT	Viti fillimit	Viti Mbari mit	VLERA TOTALE	Gjendja banke 31.12.2019	TE ARDHURA 2019	Parashiku ar derdhje UMT	SHPENZIME E 2019
1	"Implementation of cost-optimized childhood vision and hearing screening programmes in middle-income countries in Europe	2017	2020	108,014,000	7,518,471	14,000,000	0	21,518,471.00
2	"GRADUA Edvancement and Development of University Capacities in Albania-GRADUA"	2017	2020	8,129,000	68,625	3,522,281	503,200	4,025,481
	TOTAL			116,143,000	7,587,096	17,522,281	503,200	25,543,952



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 200/16 Prot.
Dt. 19.06.2020

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 2907 Prot.

Tiranë, më 17.6.2020

Lënda: Përgjigje shkrese

Drejtuar:

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
Adresa Rruga e "Dibrës", nr. 371, Tiranë

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TE UNIVERSITETIT MJEKËSISË, TIRANË
Adresa Rruga e "Dibrës", nr. 371, Tiranë

Për dijeni: MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
Adresa Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
Adresa Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës nr. 200/16 prot., datë 26.5.2020 të Universitetit të Mjekësisë Tiranë me objekt "Kërkesë për ndërhyrje", ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Në lidhje me zbatimin e legjislacionit buxhetor nga organet kolegjiale dhe individuale të IAL-ve, referuar nenit 52 të ligjit 80/2015, në pikën 1.c) janë të përcaktuara qartësisht funksionet e Administratorit sa i përket përgjegjësisë lidhur me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij. Gjithashtu, funksionet e anëtarëve të Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë janë të përcaktuara qartësisht në nenin 49 "Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë" të ligjit 80/2015 si dhe funksione të tjera të BA janë të përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, si institucioni përgjegjës për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, ka shprehur qëndrimin e saj institucional në të gjithë komunikimet që ka pasur me UMT, qëndrim i shprehur edhe me shkresën nr. 2317/2 prot., datë 22.04.2020 "Kthim përgjigje" drejtuar Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë.

Në zbatim të dispozitave të përcaktuara në pikë 2 të VKM-së nr. 807 datë 16.11.2016 të Këshillit të Ministrave "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, procedurat e prokurimit, që kanë filluar me fondet e miratuara apo në dispozicion të IAL-së, duhet të vijojnë procedurat edhe pas datës 15 Tetor, me kusht që lidhja e kontratës në këtë rast, të bëhet vetëm pasi të jetë vënë fondi në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor.

Referuar këtij përcaktimi, të gjithë institucionet publike të arsimit të lartë, i trashëgojnë fondet e veta, pra i kanë fondet në dispozicion, me përjashtim të rastit nëse me vendim të Bordit të Administrimit, fondet për këtë procedurë janë anuluar apo kanë ndryshuar destinacionin e përdorimit të tyre. Çdo procedurë prokurimi, e cila mund të ketë filluar në vitin 2019 në një institucion publik të arsimit të lartë, me fonde nga të ardhurat e veta ose fondet grand nga buxheti i shtetit, nëse nuk ka arritur të finalizojë nënshkrimin e kontratës deri në datë 31.12.2019, fondet për këtë procedurë “nuk digjen” pasi ato trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, vlerëson se nuk është produktive dhe aspak efiçente, që pas katër muajve nga ana e Bordit të Administrimit të UMT-së nuk është miratuar buxheti për vitin 2020.


Referuar ligjit 48/2014 “Për detyrimet kontraktore e tregtare”, mosmiratimi i buxhetit ka një risk të lartë me impakt financiar, pasi çënon përmbushjen detyrimeve kontraktore të nënshkruara për vitin 2020, duke sjellë penaltete apo kamatëvonesa të shtuara për pagesë pasoja, me dëm financiar për buxhetin e UMT-së.

Theksojmë se institucionet publike të arsimit të lartë, arkëtojnë tarifa shkollimi nga studentët, pagesa e të cilave duhet të ndikojë cilësisht në krijimin e kushteve më të mira të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ndaj është shumë e rëndësishme që institucionet publike të arsimit të lartë, me burimet financiare që kanë në dispozicion të realizojnë në kohë produktet e kërkuara.

Sa më sipër, kërkojmë që Bordi i Administrimit të vijoje urgjentisht procedurat për miratimin e buxhetit të institucionit, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 200/16 prot.

Tiranë, më 26.05.2020

Lënda: Kërkesë për ndërhyrje

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit nr. 3, Tiranë

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Adresa: Rruga e Durrësit, nr. 23, Tiranë

KRYETARIT
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Adresa: Rruga Sermedin Said Toptani, Tiranë

Të nderuar,

Në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ju parashtroj sa më poshtë vijon:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është një institucion publik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, krijuar me VKM-në nr. 48, datë 23.01.2013 "*Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*", i ndryshuar. Për ushtrimin e veprimtarisë së tij, UMT-ja nëpërmjet strukturave dhe autoriteteve përkatëse, përgjegjëse për anën ekonomiko financiare, ka përgatitur dhe ka vijuar me procedurat e miratimit të buxhetit të universitetit për vitin 2020, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*".


Pas kalimit të disa hapave procedurale, buxheti i UMT-së nuk është miratuar nga Bordi i Administrimit të UMT-së, si organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Anëtarët e këtij të fundit janë të ndarë në qëndrimet e tyre, dhe nuk kanë rënë dakord të miratojnë buxhetin e universitetit të vitit 2020. Kjo vjen për arsye se, një pjesë e anëtarëve të Bordit të Administrimit pretendojnë se Buxheti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nuk është hartuar në përputhje me aktet

ligjore e nënligjore që rregullojnë hartimin e buxhetit në institucionet publike në Republikën e Shqipërisë; pasi nga strukturat përkatëse janë kryer procedura prokurimesh pas datë 15 tetor të vitit 2019.

Të gjendur në këto kushte, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si organi kolegjal më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij, kërkon ndërhyrjen Tuaj, në kuadër të asistencës dhe/ose auditimit sa më të shpejtë, me qëllim zgjidhjen e kësaj situate, pasi mosmiratimi i buxhetit të universitetit, ka sjellë paralizimin e të gjithë veprimtarisë së tij, duke marrë parasysh dhe situatën në të cilën gjendemi (Pandemia e shkaktuar nga COVID – 19, viti zgjedhor në universitetet publike, situata pas tërmetit, mos pagesa e personelit akademik dhe organeve kolegjiale në UMT).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETARIE SHQIPERISE
PROF. ARBEN GJATA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1088 / Prot.

3

Tiranë, më 22/05/2020

VENDIM

Nr. 54, datë 22.05.2020

PËR
MARRJEN E MASAVE PÛRKATËSE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMATIKAVE MBI
MIRATIMIN E BUXHETIT TË UMT-SË PËR VITIN 2020


Në bazë të nenit 3, 37, 38 e vijues të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 5, 26 e vijues të Statutit të UMT-së, si situatës së krijuar për mosmiratimin e buxhetit të UMT-së për vitin 2020, Senati Akademik pasi dëgjo i përfaqësuesit e Bordit të Administrimit dhe Administratorin e UMT në lidhje me çështjen e buxhetit të universitetit,


VENDOSI:

1. T'i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kontrollit të Lartë të Shtetit në Republikën e Shqipërisë, ndërhyrjen e menjëhershëm për asistencë dhe/ose auditivin, sa më të shpejtë, me qëllim zgjidhjen e situatës së krijuar mbi mosmiratimin e buxhetit të vitit 2020 të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. T'i kërkojë njësive kryesore të UMT-së, që në kuadër të miratimit të zërave të buxhetit të UMT-së për vitin 2020, të paraqesin kërkesat dhe nevojat konkrete në lidhje me:
 - Marrjen e masave përkatëse për parandalimin e përhapjes së Covid-19, në zbatim Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 289, datë 04.05.2020 "*Për miratimin e udhëzuesit për "Masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore"*" si dhe Rregullores së UMT-së, "*Mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga Covid-19*", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 38 datë 11.05.2020 "*Për miratimin e Rregullores ...*".
 - Dëmet e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019 në godinat/ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor dhe veprimtaria administrative, me qëllim riparimin e tyre dhe kthimin në normalitet të veprimtarisë së njësive kryesore.
 - Pagesat e personelit akademik të jashtëm/të ftuar dhe organeve kolegjiale.

3. T'i kërkojë Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) të UMT-së, që në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve për autoritete dhe organe drejtuese në UMT, të përgatisë një listë paraprake të nevojave, bazuar në kërkesat konkrete që ka KIZ për realizimin e zgjedhjeve në UMT.
4. T'i kërkojë Bordit të Administrimit dhe Administratorit të UMT-së, marrjen e masave të menjëhershme për miratimin e buxhetit ku bëjnë pjesë pikat e sipërcituara, pasi situata në të cilën ndodhemi është injaft delikate dhe mos operimi në kohë do të sillte pasoja shumë të rënda në vijimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ARBEN GJATA





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 6816 / Prot. 1

Tiranë, më 27 / 4 / 2020

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Adresa: Rruga e Durrësit, Tiranë

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë

Në vijim të korrespondencës sonë, mbi menaxhimin financiar e buxhetor të institucioneve të Arsimit të Lartë Publik, i mbetemi qëndrimit tonë të shprehur në shkresën 6175/1 datë 14.04.2020, duke riargumentuar se:


Institucionet e Arsimit të Lartë, janë institucione që administrojnë fonde publike dhe fonde buxhetore, dhe për rrjedhojë, ato janë objekt i ligjit të menaxhimit financiar dhe buxhetor, përsa kohë që në ligjin specifik të fushës, nuk ka asnjë parashikim ndryshe nga legjislacioni i sipërcituar.

Mbështetur në sa më sipër, vlerësojmë që çdo procedurë jashtë përcaktimeve të këtyre ligjeve rregullatore të menaxhimit të fondeve publike, duhet të bëhet nëpërmjet ndryshimeve dhe përcaktimeve përkatëse ligjore.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Arian Kraja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 8317/Prot.,

Tiranë më 22.9.2020

Lënda:

Kthim përgjigje

MINISTRIË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

Për dijeni: BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË ✓
TIRANË

Referuar shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. prot 6175/1., datë 14.4.2020 drejtuar Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shkresë e cila shprehet se institucionet e arsimit të lartë, për sa kohë janë institucione të qeverisjes së përgjithshme dhe njëkohësisht marrin financime nga buxheti i shtetit, i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe akteve në zbatim të tyre, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i përmbahet parimit se fondet publike të institucioneve të arsimit të lartë, duhet të përdoren në përputhje me rregullat dhe standardet e menaxhimit financiar publik, për sa kohë nuk ka parashikime specifike në legjislacion, por detyrimsht, duhet të zbatohen dhe të prevalojnë përcaktimet ligjore dhe ato specifike që gëzojnë institucionet e arsimit të lartë publik sa i përket autonomisë së tyre financiare.

Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë funksionojnë dhe organizohen në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Në pikën 1, të nenit 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë" parashikohet se "Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi."

Autonomia financiare për përfitimin e fondeve buxhetore në formën e grandit/transfertë e pakushtëzuar, përveçse në ligjin 80/2015, konkretisht në nenet 111-113, është e garantuar edhe në nenin 16, të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020" si dhe në pikën 11, të kapitullit "Detajimi i fondeve buxhetore" të udhëzimit plotësues nr.2, datë 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020", ku përcaktohen procedura të veçanta për detajimin e fondeve buxhetore, të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit për fondet e arsimit të lartë.

Autonomia organizative, sikurse në ligjin 80/2015, është sanksionuar edhe në ligjin vjetor të buxhetit, ku institucionet e arsimit të lartë në ndryshim nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme, nuk përfshihen në tabelën nr.2 në të cilën detajohet numri i punonjësve.

Në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 3 "Përkufizime" përcaktohet:

- "Qeverisje e përgjithshme" sipas pikës 4) të nenit 3 është tërësia e njërive të qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale;
- "Njësi e qeverisjes qendrore", referuar pikës 5) të nenit 3 janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, ligj ose Vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore.
- "Njësi e qeverisjes vendore" referuar pikës 6) të nenit 3 janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar.
- ~~"Njësi e fondeve speciale"~~ referuar pikës 7) të nenit 3 është njësi e krijuar me ligj për të ushtruar funksione specifike të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Gjithashtu, edhe ligji nr. 10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", në pikat 4, 5, 6 dhe 7, të nenit 4, të këtij ligji, jepet i njëjti përkufizim për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, njësitë e qeverisjes qendrore, njësitë e qeverisjes vendore dhe njësitë e fondeve speciale, sikurse edhe në ligjin 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, i sipërcituar.

Në kuptim të kuadrit rregullator të sipërpërmendur, nuk cilësohet nëse institucionet e arsimit të lartë klasifikohen ose jo si njësi të qeverisjes së përgjithshme.

Në ligjin vjetor të buxhetit, neni 16 i tij, ka një parashikim specifik për fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë, të cilat shpërndahen në formën e grandit, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Në pikën 11, të udhëzimit plotësues nr. 2., datë 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020" parashikohet se "procedura të veçanta zbatohen për detajimin e fondeve buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit për arsimin e lartë, ku në pikën a.2) parashikohet se mbartja e fondit grand të arsimit të lartë të pa përdoruar gjatë vitit 2019, do të bëhet sipas strukturës së mëposhtme.

Të gjitha institucionet e arsimit të lartë rakordojnë me degët e thesarit lidhur me fondet e papërdorura gjatë vitit 2019 për grandin e arsimit të lartë përkatësisht në strukturat:

- o Grupi 11, programi 09450, kapitull 08, artikujt 600, 601, 602, 604, 605, 606.
- o Grupi 11, programi 09770, kapitull 08, artikujt 600, 601, 602, 604, 605, 606.

Një kopje e këtij akt-rakordimi, paraqitet zyrtarisht nga institucionet e arsimit të lartë tek nëpunësi i parë autorizues, për t'u mbartur në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin pasardhës.

Gjithashtu, në pikat 203-207 të udhëzimit standard nr.9., datë 20.03.2018, përcaktohet se të ardhurat e institucioneve të arsimit të lartë janë të ardhura jashtë limitit, të paplanifikuara në buxhetin vjetor.

Kryerja e shpenzimeve nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit evidentohet me strukturë të veçantë buxhetore, sipas autorizimit që bën struktura përgjegjëse për thesarin në përputhje me të ardhurat e realizuara në fakt. Këto të ardhura, të cilat trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor, çelen direkt nga struktura përgjegjëse për thesarin në nivel dege, pa autorizim nga nëpunësi i parë autorizues, pas rakordimit me njësinë shpenzuese që mbulon. Për të ardhurat jashtë limitit, në ndryshim nga fondet buxhetore, nuk bëhet regjistrim limiti në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

Sa më sipër, për të gjithë procedurat e prokurimit të cilat realizohen me fonde nga të ardhurat jashtë limitit, thesari nënshkruan regjistrin e prokurimit vetëm për ato procedura të parashikuara me të ardhurat e realizuara në fakt, pra, me fondet në dispozicion të Autoritetit Kontraktor.

Çdo procedurë prokurimi, e cila mund të ketë filluar në vitin 2019 në një institucion publik të arsimit të lartë, me fonde nga të ardhurat e veta ose fondet grand nga buxheti i shtetit, nëse nuk ka arritur të finalizojë nënshkrimin e kontratës deri në datë 31.12.2019, fondet për këtë procedurë "nuk digjen" pasi ato trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

Në lidhje me zbatimin e legjislacionit buxhetor nga organet kolegjiale dhe individuale të IAL-ve, referuar nenit 52 të ligjit 80/2015, në pikën 1.c) janë të përcaktuara qartësisht funksionet e Administratorit sa i përket përgjegjësisë lidhur me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij. Gjithashtu, funksionet e anëtarëve të Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë janë të përcaktuara qartësisht në nenin 49 "Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë" të ligjit 80/2015 si dhe funksione të tjera të BA janë të përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Për sa më sipër, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, lutemi nga ana juaj saktësimin dhe qartësimin e shkresës së adresuar Universitetit të Mjekësisë, Tiranë në lidhje me referencat ligjore për klasifikimin e institucioneve të arsimit të lartë si njësi e qeverisjes së përgjithshme si dhe


vlerësimin shterues nga ana juaj, lidhur me përdorimin e fondeve dhe zbatimin e afateve nga institucionet e arsimit të lartë, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, kërkojmë mirëkuptimin e bordit të UMT-së për të vijuar procedurat për miratimin e buxhetit të institucionit, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të tij.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MIZAKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 200/13 prot.

Tiranë, më 24.04.2020

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj me nr. 200/6 prot., datë 24.02.2020

DREJTUAR:

Z. ANDI MAHILA
ADMINISTRATOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Këtu

PËR DIJENI:

Z. ARBEN GJATA
REKTOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Këtu

ZNJ. ANYLA BULO/KASNECI
ZV/REKTOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Këtu

Z. OLTJON MUZAKA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

Të nderuar,

Në vijim të shkresës së Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me nr. 200/6 prot., datë 24.02.2020 "Relacion për parashikimin e treguesve të buxhetit për vitin 2020", të mbledhjes së Bordit të Administrimit të UMT-së të datës 27 mars 2020, si dhe të korrespondencës në vijim.

Në cilësinë e Kryetarit, kam kërkuar zhvillimin e mbledhjes, që u dakordësua më datë 09.03.2020, ku si pikë e rendit të ditës ishte përfshirë edhe diskutimi i buxhetit. Dua të vë në dukje që në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe në Rregulloren e Bordit të Administrimit, për të respektuar balancat e përfaqësimit, është parashikuar që miratimi i buxhetit të bëhet me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit të Administrimit, pra me 5 vota pro. Por duke qenë edhe në kushtet e mosplotësimit të numrit të anëtarëve në Bord, në mbledhjen e datës 09.03.2020, nuk u arrit kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje, duke qenë prezent në momentin kur do të diskutohej buxheti vetëm katër anëtarë të Bordit.

Në ditët në vijim, ka patur një korrespondencë të gjatë, në të cilën është përfshirë edhe Senati Akademik, sa i takon buxhetit. Mbledhja e radhës me rend dite buxhetin 2020, u caktua data 27.03.2020, pavarësisht pandemisë. Në këtë mbledhje u ngritën disa pyetje dhe shqetësime për buxhetin e prezantuar, që konsistonin në:

- Mosrakordim të zërave
- Aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme,
- Likuidimet dhe detyrimet e prapambetura,
- Marrja e angazhimeve përtej ndalimeve të vendosura nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë,
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit në vitin 2020, pa u miratuar buxheti, dhe në kundërshtim me rekomandimet e Agjensisë së Prokurimit Publik, etj. Si përfundim, buxheti u hodh në votim në këtë mbledhje dhe nuk u arrit kuorumi për miratim, në formatin aktual, duke patur vetëm katër vota pro. Për sa më sipër, Bordi i kërkoi informacion Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore (Drejtoria SHJBNJ) të UMT-së, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për pyetje të ngritura. Ku më datë 03.04.2020 u konfirmua nga Drejtoria e SHJBNJ që UMT, i nënshtrohet të gjithë kuadrit ligjor për financat në fuqi. Të njejtin fakt konfirmon edhe shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 6175/1 prot., datë 14.04.2020 “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr. 908/1 prot., datë 16.04.2020.

Për të mos penguar punën e institucionit, me propozim të Prof. Stringës në mbledhjen e datës 27.03.2020, ku nuk u shpreh asnjë tjetër, u propozua që të miratohet pjesa e paga, bursa, sigurime, utilitete dhe shpenzimet e nevojshme për emergjencën e COVID -19. E përsëritur kjo nga unë, në cilësinë e Kryetarit të Bordit në disa e –maile rradhazi, kërkova të shpreheshin mbi këtë propozim, i cili u kundërshtua nga disa anëtarë të Bordit, duke insistuar që të miratohet buxheti në atë formë që ishte propozuar, PA NDRYSHIME.....

Ndërkohë ende ndodhemi në këtë situatë shumë të pakëndshme, parë kjo në një kuadër më të gjerë, në atë të cilin ndodhet vendi ynë, por jo vetëm.

Më duhet të vë në dukje që propozimi i buxhetit, edhe pse nga ana ime u votua që të kalonte, ka problematika të cilat në mënyrë shumë të qartë i kanë shpalosur disa anëtarë të Bordit në mbledhje dhe në korrespondencën në ditët më pas :

- a) Na është deklaruar që buxheti për kërkimin shkencor, i projekteve të fituara nga një aplikim si universitet, nuk kanë nevojë të përfshihen në buxhetin e institucionit, edhe pse fillimisht Administratori na dërgoi tre projekte pranë Bordit që të përfshihen si zë në buxhetin e institucionit, (zëri për mbështjen e kërkimit shkencor në këtë IAL), u tërhoqën si propozime, pasi nuk qenka pjesë e buxhetit të institucionit. Por, ky institucion, operon si Autoritet Kontraktor për prokurimet që kryhen për nevoja të këtyre projekteve dhe zëri nga të cilat pritet të kryhet financimi është : “2. Burimi i Financimit: Buxheti shtetit për kërkimet shkencore”. Se ku është alokuar ky buxhet, se përse ky buxhet përdoret nga UMT, por nuk përfshihet në buxhetin e UMT, se përse nuk është kompetent Bordi për të miratuar përdorimin e gjitha fondeve që sigurohen nga burime të ndryshme, këtë e gjej shumë problematike për buxhetin.
- b) Problem tjetër që është hasur me buxhetin, që është themelore për qëndrueshmërinë dhe funksionin e Bordit si kontrollues i menaxhimit të financave, janë vonesat në likuidime të faturave, këto të

dërguara në relacionin e buxhetit dhe që janë trajtuar në mënyrë të hollësishme si në mbledhje dhe në komunikimet aktuale me MASR. Gjithashtu, në email-in e fundit të Prof. Stringës, në mënyrë të detajuar dhe shumë profesionale, janë shpalosur problematikat e hasura në këtë relacion dhe kjo tregon përkushtim e saj si anëtare Bordi dhe seriozitetin që tregon për punën.

c) Koha që kaloi nga propozimi i projekt buxhetit e deri në paraqitjen e tij në Bord, nuk i shërbeu Administratorit që të bënte një rishikim të zërave, si dhe të propozohej një parashikim për shpenzimet e situatës së emergjencës, por jo, kjo nuk ka ndodhur deri më sot. Edhe në mbledhjen e datës 27 Mars 2020, pyetjes për nevojat për rishikim të buxhetit për shpenzimet e emergjencës COVID-19 Administratori ju përgjigj se janë shpenzime minimale, pa paraqitur asnjë projekt.

Siç jeni në dijeni edhe nga korrespondenca elektronike dhe procesverbali, Bordi i Administrimit, për shkak të mosarritjes së kuorumit të nevojshëm për miratimin e buxhetit, referuar nenit 51, pika 1, germa "k", të Statutit të UMT, nuk ka siguruar 2/3 e votave pro të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit të Administrimit për miratimin e këtij propozimi. Më pas është kërkuar miratimi i zërit të pagave, sigurimeve, bursave, shpenzimet utilitare dhe shpenzimeve të nevojshme për gjendjen e krijuar nga pandemia e COVID – 19. As ky propozim nuk u miratua.

Për shkak se nga ana e anëtarëve të Bordit të Administrimit është kërkuar me këmbëngulje që të dilet me një vendim, jam i detyruar t'ju bëj me dije që në mbledhje e datës 27 mars 2020, projekt buxheti u hodh në votim "për miratim", dhe për miratimin e tij nuk u arrit shumica e cilësuar, parashikuar në refencën ligjore të sa më lartë, pra nuk ka një vendimmarrje, nuk u arrit të kishte vendim, pasi në këtë rast jemi në pakicë dhe mosarritje të numrit të nevojshëm të votave "pro".


Në këto kushte, kërkojmë që nga ana e Administratorit, si struktura përgjegjëse për hartimin e projekt buxhetit, të reflektojë kërkesat e paraqitura dhe të hartohet propozimi i projekt buxhetit të UMT për vitin 2020, sipas kuadrit ligjor në fuqi, ku në bazë të nenit 49 të Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", të nenit 35 e vijues të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", të nenit 51, të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores së Brendshme të ndryshuar për Administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si dhe të nenit 4, pika 2, të Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Nëse nga ana juaj duhet kohë që të reflektohen ndryshimet në projekt-buxhet, lutemi të dërgohet sa më parë propozimi për miratimin e përkohshëm të buxhetit(1/12) dhe të dërgohet pranë Bordit të Administrimit për vendimmarrje.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Florian TOTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 61757 Prot.

Tiranë, më 14 2020

Lënda: Kthim përgjigje

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë

Për dijeni:

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË


Adresa: Rruga e Durrësit, Tiranë

Në vijim të shkresës suaj nr. 908prot., datë 31.03.2020 nëpërmjet të cilës kërkohet nëse Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është i përjashtuar nga kërkesat e Ligjit Organik të Buxhetit dhe akteve të tjera në zbatim të tij, ju informojmë se për sa kohë Institucionet e Arsimit të Lartë janë institucione të qeverisjes së përgjithshme dhe njëkohësisht marrin financime nga buxheti i shtetit ato i nënshtrohet kërkesave të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe akteve në zbatim të tyre.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Arian Kraja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 200/114 Prot.

Tiranë, më 30.04 2020

Lënda: Përgjigje arsyeve për mosmiratimin e buxhetit të vitit 2020

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT ✓
REKTORATIT**

Për dijeni: MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Me shkresën nr. 200/6 prot., datë 24.02.2020 "*Relacion për parashikimin e treguesve të buxhetit për vitin 2020*", kemi përcjellë tek Ju, buxhetin e miratuar paraprakisht nga Rektorati i UMT-së, me Vendimin nr.3, datë 18.02.2020, sipas përcaktimeve të germës g, të nenit 31, të Statutit të UMT-së, si dhe buxhetin e propozuar pas miratimit, nga Senati Akademik, me Vendimin nr.19, datë 21.02.2020, sipas përcaktimeve të germës h, të pikës1, të nenit 38, të ligjit nr.80/2015 dhe të germës j, të nenit 26 të Statutit të UMT-së.

Me shkresë nr.200/13 prot, datë 27.04.2020 "*Kthim përgjigje shkresës suaj nr.200/6 prot, datë 24.02.2020*", në të cilën keni renditur arsyet e vendimit të marrë nga Bordi i Administrimit për mosmiratimin e buxhetit, Ju sqarojmë edhe njëherë sa më poshtë vijon:

Përpara mbledhjes së datës 27.03.2020, Bordi i Administrimit ka paraqitur nëpërmjet shkresës nr.200/7 prot, datë 12.03.2020 "*Kërkesë*", 20 pyetje në lidhje me parashikimin e treguesve të buxhetit për vitin 2020 dhe probleme të tjera që nuk lidheshin direkt me parashikimin e treguesve të buxhetit. Me shkresën nr.200/85 prot, datë 17.03.2020 "*Përgjigje pyetjeve*", Ju dërguam përgjigjet për pyetjet e bëra.

Në datë 23.03.2020, në formë elektronike, Bordi i Administrimit ka paraqitur përsëri, një listë me 7 pyetje, prej të cilave 4 pyetje u plotësuan me dokumentacion nga ana jonë, njëra ishte pyetje e përsëritur së cilës ne i kishim kthyer përgjigje në shkresën e mësipërme, kurse vënia e dokumentacionit në dispozicion lidhesh me praninë e të gjithë punonjësve në punë, edhe të Njësive Shpenzuese (Fakulteteve), që për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, nuk ishin prezent.

Në datën 27.03.2020, ora 09:00, u zhvillua mbledhja e Bordit të Administrimit, me temë: *“Diskutim mbi buxhetin 2020”*, me prezencën e përfaqësuesve të sektorëve administrativ-financiar të secilit Fakultet, me prezencën e përfaqësuesve akademikë, Prof. Anyla Bullo, e ngarkuar me detyrat e Rektorit, Prof. asc Manika Kreka e deleguar nga Dekania e FSHMT-së dhe të gjithë anëtarët e Bordit të Administrimit të UMT-së. Në këtë mbledhje që zgjati 2 orë e gjysmë, u dhanë edhe njëherë sqarimet e nevojshme në detaje, në përgjigje të pyetjeve të ndryshme të anëtarëve të Bordit.

Në këtë mbledhje dhe as në shkresat e tjera të përmendura më lart, nuk janë ngritur ndonjëherë këto probleme që Ju pretendoni se u diskutuan në mbledhje apo që strukturat administrative të institucionit të jenë në dijeni zyrtarisht nga Bordi i Administrimit.

Pas mbledhjes për shqyrtimin e buxhetit dhe pas dërgimit të më shumë se 250 faqeve (që kur ka filluar nga ana e Bordit të Administrimit procesi i shqyrtimit të parashikimeve të treguesve të buxhetit 2020,) me të dhëna, shifra, statistika, sqarime specifike dhe çdo gjë tjetër të nevojshme, që janë kërkuar nga anëtarët e Bordit të Administrimit, të përgatitura nga strukturat përgjegjëse ekzekutive administrative-financiare të institucionit, ka pasur një komunikim të madh në numër, në rrugë elektronike, nga anëtarë të bordit, në disa prej të cilave kanë shprehur lloj lloj gjetjesh, mendimet dhe vlerësimet e tyre personale, në disa raste irrelevante, të mbushura me alogisma deri në akuza të drejpërdrejta, intimidime dhe kërcënime.

Me këto komunikime janë njohur përfaqësuesit e lartë të MASR-së dhe MFE-së. Në disa prej tyre Administratori i UMT-së ka qenë i vendosur në cc.

Mënyra e funksionimit dhe procedurat që ndiqen nga organi kolegjal (Bordi i Administrimit), në një procedurë administrative janë të përcaktuara në mënyrë shteruese në legjislacionin shqiptar.

Çdo individ, anëtar i një organi kolegjal (Bordi i Administrimit) ka mendimet dhe vlerësimet e veta, mbi bazën e të cilave kryen aktivitetin e tij, si pjesë e këtij organi dhe mban përgjegjësi individuale ligjore, për çfarëdo kryen dhe deklaron.

Por, çdo individ (anëtar i Bordit të Administrimit) nuk është vetë organi i Bordit të Administrimit. Organi kolegjal (Bordi i Administrimit) vepron si një grup personash dhe shprehet zyrtarisht, me format dhe mënyrat e përcaktuara, pasi të jetë kryer procesi i votimit apo i dakortësisë së shumicës së anëtarëve, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.

Komunikimi i fundit zyrtar midis Bordit të Administrimit dhe strukturës përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit në UMT -së, në kuadër të procedurës së miratimit të buxhetit të vitit 2020, është i datës 27.03.2020.

Buxheti është procesi i projektimit të të dhënave financiare. Është plan-parashikim i veprimtarisë financiare për një periudhë të caktuar kohore (vit fiskal), që tregon të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara.

Arsyet e pretenduara nga Bordi i Administrimit për vendimin e marrë për mosmiratimin e buxhetit të UMT-së për vitin 2020, (në mbledhjen e datës 27.03.2020 dhe të cilat zyrtarisht na janë bërë prezent me shkresën nr. 200/13, datë 27.04.2020) i cili, buxhet, është propozuar si i tillë nga Senati Akademik me Vendimin nr.19, datë 21.02.2020, në materialet e të cilit pasqyrohen dhe sqarohen me detaje të gjitha investimet që secila Njësi Shpenzuese ka parashikuar që të kryejë, mbështetur në përcaktimet ligjore, të bazuara në kërkesat e Departamenteve; të shqyrtuara dhe të miratuara në Dekanatet respektivë; më pas në Rektorat dhe të ratifikuara nga Senati Akademik, organe këto të cilat, bazuar në ligj, përcaktojnë prioritetet e investimeve, gjithmonë në shërbim të mësimdhënies dhe të procesit mësimor, bazuar në planin strategjik afatmesëm të institucionit, **nuk kanë të bëjnë me procesin e miratimit të buxhetit.**

Nga arsyet e paraqitura zyrtarisht nga Bordi i Administrimit, për mosmiratimin e buxhetit të UMT-së për vitin 2020, sqarimet e të cilave për korrektëse, seriozitet dhe transparencë, i paraqesim edhe njëherë më poshtë, duke përjashtuar vetëm shqetësimin e “mosrakordim të zërave”, të gjitha të tjerat kanë të bëjnë me procesin e zbatimit të buxhetit të një viti më parë, që i takon procesit të shqyrtimit dhe miratimit të veprimtarisë së institucionit për vitin 2019.

Në analizën vjetore financiare për vitin 2019, e cila është shqyrtuar dhe miratuar nga Senati Akademik edhe nga Bordi i Administrimit, me Vendimin e Përbashkët nr. 18, datë 21.02.2020 *“Për miratimin e raportit vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore, për vitin akademik 2018-2019 dhe veprimtarinë financiare për vitin 2019, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*, e publikuar në faqen zyrtare të UMT-së, si dhe e depozituar pranë MASR-së, nuk u evidentua asnjë nga problemet që tani referohen nga disa anëtarë të Bordit të Administrimit dhe që për më tepër përdoren si arsye për mosmiratimin e buxhetit të vitit 2020.

Kuintesenca e veprimtarisë së strukturave administrative –financiare të UMT-së, në kryerjen e detyrave që ligji na ngarkon, për këto dy vite, është puna korrekte dhe transparente e kryer me ndershmëri, e cila, siç rezulton nga të dhënat zyrtare të UMT-së ka si rezultat:

- rritjen e qëndrueshme të të ardhurave të institucionit, që për vitin 2019 arritën në 96%, me një rritje prej 4% më shumë se vitit 2018 dhe 8% më shumë se vitit 2017;
- rritjen e qëndrueshme të kryerjes së shpenzimeve në plotësim të nevojave të kërkuara nga njësitë bazë (departamentet) në mbështetje të procesit mësimor, që për vitin 2019 arritën në 12,8% më shumë se viti 2018 dhe 72,9% më shumë se viti 2017;
- dhe rritjen e qëndrueshme të investimeve, që për vitin 2019 arritën në 127% më shumë se viti 2018 dhe 346.2% më shumë se viti 2017;
- garantimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit.

1. Mosrakordim i zërave buxhetor

Gjatë zhvillimit të mbledhjes së datës 27.03.2020, u deklarua nga Kryetari i Bordi të Administrimit se, **ka pasaktësi dhe mosrakordim shifrash në tabela.**

Edhe pse, gjatë mbledhjes ju kërkua nga ana e Administratorit (tre herë) të faktonte sa pretendon, nuk faktoi asnjë pasaktësi dhe asnjë mos rakordim shifrash në tabela.

Duam të theksojmë se procesi i hartimit dhe i shqyrtimit të buxhetit është një proces që buron nga pjesmarrja aktive dhe kontributi i të gjithë aktorevë që janë pjesëmarrës përfshirë dhe Bordin e Administrimit. Nëqoftëse Ju, do ta kishit konstatuar një gjë të tillë, keni pasur mundësinë për të na e evidentuar si problem, në mënyrë që dhe ne të reflektonim për rregullimin e tij ashtu siç ka ndodhur dhe gjatë procesit të miratimit të buxhetit për vitin 2018 dhe 2019, ku ne kemi reflektuar çdo vërejtje dhe sugjerim të Bordit të Administrimit për mënyrën e paraqitjes së tabelave të Buxhetit. **Tabelat e buxhetit 2020, me disa shtesa për të sqaruar më shumë treguesit e paraqitur, janë të njëjta me buxhetin e vitit 2018 dhe 2019, të cilët janë miratuar nga Bordi i Administrimit,**

E vetmja vërejtje e Juaja ka qënë për tabelën e dy projekteve të huaja, ku ishte vendosur plani i disbursimeve të pritshme dhe i shpenzimeve të pritshme, e cila krijonte përshtypjen e gabuar të humbjeve ndërkohë që nuk ishte vendosur gjendja e fondeve në bankat e nivelit të dyte, e cila nuk prek aspak thelbin e buxhetit të hartuar dhe u sqarua nga ne gjatë takimit të zhvilluar.

2. Aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme

Shkresa nr. 200/6 prot., datë 24.02.2020 “*Relacion për parashikimin e treguesve të buxhetit për vitin 2020*”, me anë të së cilës janë paraqitur zyrtarisht treguesit e parashikuar për buxhetin e UMT-së për vitin 2020, fillon pikërisht me bazën ligjore, mbi të cilën është mbështetur hartimi i buxhetit. Mbështetja mbi legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, paraqitet edhe më i detajuar në rregulloren e brendshme financiare të institucionit e cila është riparë nga specialistët e MFE-së dhe miratuar nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik.

3. Likuidimet dhe detyrimet e prapambetura

a- Siç Ju kemi sqaruar në të dy shkresat tona nr.200/8 prot, datë 17.03.2020 dhe 200/10 prot, datë 25.03.2020, por edhe në mbledhjen e datës 27.03.2020, Njësitë Shpenzuese të UMT-së, në datë 31.12.2019, detyrime të prapambetura që kishin kaluar detyrimin e 30 ditëve të palikujduara, kishin 2 fatura me vlerë 600,640 lekë dhe detyrime me fatura të muajit dhjetor duke përfshirë dhe detyrimet për utilitetet, për të gjitha njësitë shpenzuese janë në vlerën 6,753,932 leke (përfshirë brenda saj dhe vlerën 600,640 lekë).

Këto janë detyrime që në kuptim të gërmës “a”, nenin 61 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 8, të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku thuhet se:

Metoda e shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me;

a) *Njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre pavarësisht nga data e pagesës.*
përbëjnë detyrime të njohura të marra në dorëzim dhe të dokumentuara me dokumentacionin përkatës dhe që janë përfshirë në bilancet e vitit 2019. Këto detyrime paguhen në vitin 2020, menjëherë me miratimin e buxhetit pasi fondet për keto detyrime parashikohen në buxhet në zërin “detyrime për projekte/kontrata në vazhdim”.

b- Për sa i përket procedurave të prokurimit që në datë 31.12.2019 kanë qënë në faza të ndryshme të këtij procesi ose në fazën e zbatimit, Ju sqarojmë edhe njëherë si më poshtë vijon:

Në zbatim të pikës 81, të kapitullit “E drejta për të kryer shpenzime” e Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ku thuhet se:

81. *Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria përgjegjëse për financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime dhe në pikës 37, kapitulli “Kontrolle financiare paraprake në procesin e menaxhimit të fondeve publike” të Udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, UMT-ë ka dorëzuar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019 në Drejtorinë e Thesarit, Tiranë pas hedhjes në faqen zyrtare të APP-së me shkresën nr.1.401prot., datë 17.05.2020 “Dërgohet regjistri i prokurimeve për vitin 2019” dhe ka paraqitur urdhërat e prokurimit në thesar përpara fillimit të procedurave.*

Të gjitha angazhimet për prokurime nuk janë nga buxheti i shtetit, por me vetëfinancim, të krijuara nga të ardhurat jashtëlimitit të institucionit. Në pikën 203, të udhëzimit standart nr.9, datë 20.03.2018 thuhet se *“Të ardhurat jashtë limitit janë të ardhura të paplanifikuara në buxhetin vjetor që sigurojnë njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe që përdoren prej tyre sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.”* Urdhërat e prokurimit të Institucionit tonë nuk regjistrohen në sistemin e thesarit dhe nuk marrin numër SIFQ.

Referuar pikës 81, të udhëzimit standart nr.9, datë 20.03.2018, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë nuk ka *limite të miratuara për angazhime në thesar*, pasi të gjitha angazhimet për shpenzime të marra deri në fund të vitit 2019, i ka pasuar nga të ardhurat jashtë limitit, të cilat përshkruhen në pikat 203-209, të kapitullit IV “Procedurat standarte për menaxhimin e të ardhurave” të po këtij udhëzimi. Në pikën 206 dhe 207 thuhet:

pika 206. Të ardhurat jashtë limitit të papërdorura dhe që mbarten në vitin buxhetor pasardhës çelen direkt nga struktura përgjegjëse për thesarin në nivel dege, pa autorizim nga Nëpunësi i Parë Autorizues pas rakordimit me njësinë shpenzuese që mbulon;

pika 207 Në të ardhurat jashtë limit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës përfshihen (b)Të ardhurat nga arsimi i lartë;

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të gjitha angazhimet e marra për vitin 2019, i ka kryer në përputhje me buxhetin e vitit 2019, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.05.2019 “Për miratimin e treguesve të Buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,” dhe nuk ka marrë asnjë angazhim jashtë tij ose në mungesë të fondeve, pasi fondet i trashëgon dhe i ka të disponueshme në vitin pasardhës, referuar përcaktimit në ligjin specific 80/2015 si dhe VKM nr. 75 datë 12.02.2018.

Në fillim të vitit 2019, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë kishte këtë strukturë të ardhurash të trashëguar në fillim të vitit të regjistruar në sistemin e thesarit e cila është përfshirë si burim në buxhetin e vitit 2019:

600 +601	252,948 mijë/ lekë
602	299,435 mijë/ lekë
231	177,479 mijë/lekë
Total:	729,862 mijë/ lekë

dhe në fund të vitit 2019, strukturën e mëposhtme:

600+601	276,650 mijë/lekë
602	236,607 mijë/lekë
231	198,337 mijë/ lekë
Total	711,594 mijë/lekë

e cila është përfshirë si burim në buxhetin e vitit 2020.

Konkretisht procedurat që janë hapur në vitin 2019, janë paraqitur në një zë të veçantë në pasqyrat e parashikimit të buxhetit për vitin 2020, të cilat në mënyrë analitike paraqiten më poshtë:

1.Materiale për ngrohje (naftë)

Vlera 6,530,000 lekë, për këtë shpenzim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me **Urdhër Prokurimi nr.126, datë 26.09.2019** me objekt *“Blerje karburanti për ngrohje e sallave të leksioneve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”* me fond limit pa tvsh 5,441,666 lekë. (marrëveshje kuadër).

Kontratat për këtë shërbim janë lidhur nga njësitë shpenzuese si më poshtë:

FSHMT në datë 25.11.2019

FM në datë 24.12.2019

2. Materiale dhe reagent

Vlera 6,238,000 lekë, për këtë shpenzim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 *“Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me **Urdhër Prokurimi nr.121, datë 24.09.2019** me objekt *“Blerje material laborator dhe reagent për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”* me fond limit pa tvsh 5,173,307 lekë.

Kontratat për këtë shërbim janë lidhur nga njësitë shpenzuese si më poshtë:

FM në datë 02.12.2019

FSHMT në datë 03.12.2019

FMD në datë 27.11.2019

3.Sigurim specializantësh

Vlera 11,306,667 lekë, për këtë shpenzim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 *“Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me **Urdhër Prokurimi nr.61, datë 24.07.2019** me objekt *“Blerje siguracioni për sigurimin e shëndetit dhe përgjegjësisë profesionale të specializantëve”* me fond limit pa tvsh 11,306,605.34 lekë (marrëveshje kuadër).

Kontratat për këtë shërbim janë lidhur nga njësitë shpenzuese si më poshtë:

FM në datë 11.11.2019

FMD në datë 11.11.2019

4. Organizim i cermonisë së diplomimit

Vlera 3,960,000 lekë, për këtë shpenzim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me *Urdhër Prokurimi nr.236, datë 30.12.2019* me objekt “Shërbim për organizim cermonie diplomimi të studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit pa tvsh 3,298,000 lekë.

Kontrata për këtë shërbim është lidhur nga Rektorati në datë 06.02.2020, pasi fondet kanë qenë të disponueshme në llogarinë e thesarit.

Të gjitha këto kontrata janë regjistruar dhe janë obliguar nga dega e thesarit, në përputhje me buxhetin në dispozicion dhe në asnjë rast nuk jemi në kushtet e krijimit të detyrimeve të prapambetura apo të marrjes së angazhimeve buxhetore të pambuluara me fonde.

INVESTIME

1. Blerje paisjesh kompjuterike.

Vlera 14,954,000 lekë, për këtë investim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me *Urdhër Prokurimi nr.173, datë 30.10.2019* me objekt “Blerje paisjesh kompjuterike për sallat e Universitetit të Mjekësisë”, me fond limit pa tvsh 12,450,390 lekë.

Kontratat për këtë shërbim janë lidhur si më poshtë:

Rektorati	28.01.2020
FSHMT	28.01.2020
FM	05.02.2020

Kontratat janë regjistruar në sistemin e thesarit dhe janë obliguar, pasi fondet kanë qenë të disponueshme dhe të trashëguara nga viti 2019. Në asnjë rast nuk jemi në kushtet e krijimit të detyrimeve të prapambetura apo të marrjes së angazhimeve buxhetore të pambuluara me fonde.

2. Krijim kabinetesh

Vlera 38,587,383 lekë, për këtë investim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me **Urdhër Prokurimi nr.165, datë 25.10.2019** me objekt “Krijim kabinetesh mësimore për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike”, me fond limit pa tvsh 32,045,399 lekë. (Procedurë me lote).

Kontrata për tre lote të realizuara është lidhur nga FSHMT sipas loteve: loti i parë në datë 28.01.2020, loti i dytë në datë 17.01.2020 dhe loti i tretë në datë 21.01.2020.

Kontratat janë regjistruar në sistemin e thesarit dhe janë obliguar, pasi fondet kanë qenë të disponueshme dhe të trashëguara nga viti 2019. Në asnjë rast nuk jemi në kushtet e krijimit të detyrimeve të prapambetura apo të marrjes së angazhimeve buxhetore të pambuluara me fonde.

3. Sistemi multimedial Audovizual

Vlera 3,150,000 lekë, për këtë investim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me **Urdhër Prokurimi nr.94, datë 26.08.2019** me objekt “Blerje instalim i sistemit audiovizual i centralizuar për sallat e leksioneve të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit pa tvsh 2,624,910 lekë.

Kontrata është lidhur nga FM në datë 13.11.2019

Kontratat janë regjistruar në sistemin e thesarit dhe janë obliguar, pasi fondet kanë qenë të disponueshme dhe të trashëguara nga viti 2019. Në asnjë rast nuk jemi në kushtet e krijimit të detyrimeve të prapambetura apo të marrjes së angazhimeve buxhetore të pambuluara me fonde.

4. Rikonstruktion i sallës së parakliniku, bodrumet e dekantit

Vlera 19,680,000 lekë, për këtë investim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me *Urdhër Prokurimi nr.85, datë 15.08.2019* me objekt *“Rikonstruksion i taracës së godinës së paraklinikut dhe bodrumeve të godinës së dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”*, me fond limit pa tvsh 16,399,882 lekë.

5. Blerje paisje laborator

Vlera 38,750,000 lekë, për këtë investim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 *“Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me *Urdhër Prokurimi nr.175, datë 31.10.2019* me objekt *“Blerje të paisjeve mjekësore laborator për Fakultetin të Mjekësisë, Tiranë”*, me fond limit pa tvsh 32,285,492 lekë.

6. Furnizim vendosje dere të blinduar dhe vetratë metalike biblioteke

Vlera 1,350,000 lekë, për këtë investim është parashikuar në treguesit e buxhetit për vitin 2019, që është miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019 *“Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*.

Procedurat për këtë prokurim kanë nisur me *Urdhër Prokurimi nr.141, datë 04.10.2019* me objekt *“Instalim dhe furnizim rafte hekuri, dollap hekuri, dyer të blinduara dhe vetrata metalike”* me fond limit pa tvsh 1,124,571.27 lekë.

Kontrata është lidhur nga Rektorati në datë 04.12.2019.

Gjithashtu bazuar VKM-së nr.177, dt 04.04.2019, është lidhur kontratë me shoqërinë me kapital 100% shtetëror *“Illyrian Guard”*.

7. Marrja e angazhimeve përtej ndalimeve të vendosura nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

- a- Përsa i përket konstatimit Tuaj, që në kemi marrë angazhime përtej ndalimeve të vendosura nga MFE, Ju sqarojmë edhe njëherë se:

Në përputhje me pikën 1, të VKM nr.807, datë 16.11.2016 *“Për disiplinimin e fondeve buxhetore”* të ndryshuar, e cila thotë:

“Në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.

dhe pikës 2, të rekomandimit nr.81157, datë 14.10.2019 “Rekomandim mbi shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2020” të APP-së, mbas datës 15 tetor 2019, Autoriteti Kontraktor në zbatim Ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; të neni 4, kreu I, të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 01, datë 05.01.2018 “Për Hartimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik...”, ka hartuar regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimeve publike në përputhje me vlerat e parashikuara në buxhetin e vitit 2019, miratuar nga Bordi Administrimit, i cili pasi kontrollohet, miratohet dhe publikohet nga APP, depozitohet në degën e Thesarit. Në asnjë rast nuk kemi zhvilluar asnjë procedurë prokurimi të paparashikuar në regjistrin e Parashikimit të Prokurimit Publik pas kësaj date dhe burimi i fondeve për këto procedura nuk kanë qenë fondet e buxhetit të shtetit, por *fondet nga të ardhurat jashtëlimitit dhe të depozituara në Drejtorinë e Thesarit, Tiranë.*

b- Në lidhje me zbatimin e shkresës nr.21920 prot, datë 02.12.2019 “Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjëndjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore” të Ministres së MFE-së, ku në pikën 2 thuhej: *Autoritetet kontraktore ndalohen menjëherë të nënshkruajnë kontrata të reja, që janë në proces prokurimi apo të ndërmarrin procedura të reja prokurimi me fonde publike (përveç fondeve të emergjencës/fatkeqësisë), sqarojmë se:*

MASR-ja me e-mail, na ka dërguar shkresën nr.21920/14 prot, datë 12.12.2019 “Mbi shkresën nr.21920 prot, datë 02.12.2019” të Ministres së Financave dhe Ekonomisë, të cilat Jua kemi vënë në dispozicion dhe ku është bërë sqarimi i pikës 2, të shkresës së mësipërme të përmendur më lart, si më poshtë:

Për fondet buxhetore në proces prokurimi, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, vijojnë procedurat e prokurimit dhe marrin angazhime buxhetore nga viti 2020 e më tej. (bashkëlidhur shkresa)

8. Zhvillimi i procedurave të prokurimit në vitin 2020, pa u miratuar buxheti

Në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit për vitin 2020, Ju sqarojmë edhe njëherë se, vetëm një procedure prokurimi ka filluar dhe është çelur në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe kjo i përket projektit me vlerë 8,500,000 lekë, me emërtim “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simultante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infraktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale auotologa në rrugë të ndryshme” me drejtues projekti Prof.Edvin Prifti.

Siç Ju kemi relatuar në informacionin nr.2410/8 Prot, datë 25.11.2019 “Informacion mbi projektet e punës kërkimore shkencore të fituara nga UMT-ë, në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencore”, Universiteti i Mjekësisë fitoi tre projekte pranë AKKSH-së. Për dy nga projektet e fituara, fondet digjeshin në datë 31.12.2019, ndërsa për projektin e mësipërm që ishte projekt i miratuar me shtrirje dy vjeçare, fondet trashëgoreshin në vitin pasardhës. Në

po këtë informacion, Ju kemi shpjeguar se, nga ana e Bordit të Administrimit të UMT-së mbetej për t'u miratuar pjesa e bashkëfinancimit, që do ta paraqesim pas miratimit të buxhetit të viti 2020, kjo se sipas VKM nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” dhe pikës 8, kapitulli “Skema e miratimit dhe e zbatimit të fondeve “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese”, si dhe Udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) në të cilën thuhet:

Fondet e miratuara me ligjin vjetor të buxhetit “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese”, në programin buxhetor 09770, kapitullin 01, artikulli 604, rishpërndahet me vendim të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me përfitues institucionet e arsimit të lartë, të akredituara, që zhvillojnë kërkim shkencor, në programin buxhetor 09770, kapitulli 08, artikulli 602–606. Vendimi i bordit, së bashku me tabelat shoqëruese të detajimit të buxhetit, dërgohen zyrtarisht, si edhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t'u regjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ), të drejtën e miratimit që ka Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Bordi i Administrimit të UMT-së nuk mund të pengojë ose të tjetërsojë përdorimin e këtyre fondeve. Për realizimin e fondeve të këtij projekti kemi pasur një komunikim zyrtar me kërkesa nga MASR-ë gjatë periudhës tetor-dhjetor 2019 dhe në datë 31.12.2019, jemi thirrur në takim nga zv/Ministri i Arsimit, në prezencë të Drejtores së AKKSHI-së dhe Drejtores së Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ku na është kërkuar të kryejmë sa më shpejt procedurat për vënien në zbatim të këtij projekti. Në datë 11.02.2020 MASR-ë na është ridrejtuar përsëri ku në vazhdim të takimit të datës 31.12.2020, kërkon informacion për finalizimin e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave të fondeve të projekteve të kërkimit shkencor, fondet e të cilave janë trashëguar në vitin 2020 për çdo IAL-ë publike.

Përsa i përket paraqitjes së këtij projekti në buxhetin e vitit 2020, Ju sqarojmë se ky projekt është përfshirë në tabelat e paraqitura pranë Bordit të Administrimit, konkretisht:

Në tabelën 1, Grant i trashëguar:

Programi 9450 llogaria ekonomike 600 vlera	42,771,313 lekë
Programi 9450 llogaria ekonomike 601 vlera	22,287,414 lekë
Programi 9450 llogaria ekonomike 606 vlera	39,616,346 lekë
Programi 9770 llogaria ekonomike 602 vlera	8,500,000 lekë
TOTALI:	113,175,073 lekë

Në tabelen 9, Parashikimi analitik i shpenzimeve për vitin 2020” në shumën e zërit 6021.099 “Të tjera material dhe shërbime special” në pjesën e ndarë veçmas nga granti është

shifra 8,500,000 lekë që i përket fondeve të këtij projekti. Këto fonde janë disponibël në llogarinë e thesarit, Tiranë.

Përsa i përket konstatimit Tuaj në lidhje me vonesat në likuidimin e faturave, Ju sqarojmë edhe njëherë se, ndjekja e këtij procesi ka qënë prioritet i strukturave drejtuese të menaxhimit financiar, në institucionin tonë. Gjatë vitit 2019 ka pasur vetëm dy fatura të likujduara jashtë afatit 30 ditor për të cilat menaxhimi i ka analizuar dhe i ka kthyer përgjigje MFE-së.

Përsa i përket detyrimeve të raportuara nga jonë në MASR-ë, Ju sqarojmë se, këto detyrime i përkasin tremujorit të parë të vitit 2020, sepse pavarësisht mosmiratimit të buxhetit Njësitë Shpenzuese zhvillojnë aktivitetin. Përveç dy faturave të vitit 2019 të palikujduara, detyrimet e tjera janë të krijuara gjatë 3-mujorit të parë 2020 dhe përbëhen nga detyrimet:

- ✓ për rojet private për tre muajt janar, shkurt, mars për tre njësi shpenzuese,
- ✓ lënda djegëse,
- ✓ kontrata në vazhdim për furnizimin për material laboratorit e reagent për të tre Njësitë Shpenzuese,
- ✓ rimbursimi i telefonave, postës, OSHE-së,
- ✓ materialet elektronike për Rektoratin dhe Fakultetin e Mjekësisë,
- ✓ shpenzimet e kryera për riparimet nga tërmeti si dhe disa shpenzimesh emergjencia të ndodhura gjatë kësaj periudhe nga të tre Njësitë Shpenzuese.

Përsa i përket kërkesës për rishikim të zërave të buxhetit, siç referohet në shkresën e Bordit të Administrimit nr. 200/13, datë 27.04.2020, deri më sot, nga ana e Bordit të Administrimit nuk kemi asnjë kërkesë zyrtare, se cilët zëra vlerëson Bordi i Administrimit që duhen rishikuar, proces ky që për shkak të organizimit të institucionit tonë, me Njësi Shpenzuese më vete, do të kërkojë angazhimin për rishikimin dhe rimiratimin e të gjitha ndryshimeve të propozuara nga të gjitha organet që sipas ligjit 80/2015, statutit dhe rregullores së UMT-së, e kanë për detyrë të miratojnë dhe t'ja propozojnë për miratim Bordit të Administrimit, siç janë departamente respektivë, dekanatet respektivë, rektorati dhe senati akademik.


Lutemi paraqitjen e zërave që Bordi i Administrimit kërkon që të rishikohen.

Së fundmi, në përgjigje të kërkesës Suaj, të datës 27.04.2020, nëpërmjet shkresës nr. 200/13 prot., do të punojmë për detajimin e 1/12 të shpenzimeve faktike të vitit 2019, për periudhën janar - maj 2020.

Me mirëkuptim,


ADMINISTRATORI

Andi MAHILA





REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREKTORIA E FINANCAVE VENDORE



Plus - 1409/156

Nr. 21920/ Prot.

Tiranë, më 12/12/2019

Lënda: Mbi shkresën nr. 21920 Prot, datë 02.12.2019

Ministritë/Institucionit Qendror Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinise Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

DREKTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT


DEGJES E THESARIT

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 21920, datë 02.12.2019 nëpërmjet së cilës është përaktuar prioriteti i pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme në lidhje me pikën 2, ju bëjmë me dije se:

Së pari, autoritetet kontraktore duhet të procedojnë normalisht me procesin e realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël dhe blerjet emergjente në funksion të ofrimit normal të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Së dytë, për fondet buxhetore në proces prokurimi, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, vijojnë procedurën e prokurimit dhe marrin angazhime buxhetore nga viti 2020 e më tej.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REKTORATI

DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE E BURIMEVE NJERËZORE

SEKTORI JURIDIK

Nr. 200 / 39 prot.

Tiranë, më 11.06.2020

Lënda: Kthim përgjigje

**BORDIT TË ARDMINISTRIMIT
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

I nderuar z. Kryetar,

Në përgjigje të kërkesë Suaj nr. 200/33 prot., datë 08.06.2020 “Kërkesë për interpretim juridik”, në lidhje me vendimmarrjen për miratimin e buxhetit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ju informojmë si më poshtë vijon:

- Bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Administrimit të UMT-së është organi më i lartë kolegjal administrativ i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
- Bazuar në nenin 49, pika 1, germa c) të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se, Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij.
- Bazuar në nenin 51, pika 1, germa k), të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë parashikohet se Bordi i Administrimit miraton me 2/3 e votave , pas miratimit nga Senati Akademik buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit
- Bazuar në nenin 4, pika 1, germa c) dhe pika 2 e Rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të UMT, të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 49, datë 31.07.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e Bordit të Administrimit të universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, parashikohet se vendimet lidhur me miratimin e buxhetit vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit merren me jo më pak se 3/5 e votave të anëtarëve të Bordit.

Sa më sipër, duke marrë parasysh se Bordi i Administrimit të UMT-së është organi kolegjal i cili miraton përfundimisht buxhetin e UMT-së, por që në votimin e mbledhjes së datës 27.03.2020, nuk ka arritur të konkludojë në një vendimmarrje bazuar në përcaktimet ligjore të sipërcituara, ju risjellim në vëmendje se veprimtaria juaj administrative rregullohet edhe nga ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*, i referohemi nenit 14 të tij në të cilin parashikon se:

*“1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.
2. Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë do të përsëritet e njëjtë situatë, vendimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen tjetër,”*

Në vijim Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë duhet të vijonte me vendimmarrjen e tij për rivotim dhe më pas caktimin e mbledhjes pasardhëse për miratimin e buxhetit të UMT-së, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Ndërsa përsa i përket vendimmarrjes së Bordit të Administrimit dhe zbardhjes së Vendimeve, Ju e keni sanksionuar në nenin 16 të Rregullores Suaj *“Për funksionimin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*, ku citohet se:

“Vendimet e Bordit të Administrimit zbardhen nga sekretari, jo më vonë se tre ditë nga përfundimi i mbledhjes. Ato hartohen në tre kopje të cilat nënshkruhen ...”

Sa më sipër si bazuar në kërkesën tuaj, ju nuk mund të dilni me një vendim për mbledhjen e datës 27.03.2020 për shkak të përcaktimeve ligjore mbi çështjen e trajtuar mësipër.

Në përfundim ju sugjerojmë të vlerësoni dispozitat e rregullores tuaj të brendshme me qëllim harmonizimin e tyre me Statutin e UMT-së si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi duke pasur në vëmendje dhe detajimin e përcaktimeve në dispozitat e saj me qëllim moslënien vend për interpretim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORI
ARBEN GJATA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2185/ Prot.

Tiranë, më 18.5.2020

Lënda: Kthim përgjigje

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, nr. 371, 1005, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 911/4 prot., datë 23.4.2020 me lëndë "Kërkesë për përgjigje shteruese", ju bëjmë me dije si vijon:


Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në zbatim të pikës 7, të nenit 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", respekton lirinë akademike, autonominë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të institucioneve të arsimit të lartë. Zbatimi i përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, realizohet nga strukturat kompetente pranë IAL-së, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara për secilin organ individual apo kolegjial.

Universiteti i Mjekësisë Tiranë, gëzon të gjitha kapacitetet administrative, vendimmarrëse dhe profesionale për të realizuar zbatimin e detyrave funksionale sipas legjislacionit në fuqi. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e ka bërë me dije qëndrimin e saj me shkresën nr. 2185/1 prot., datë 22.4.2020, të cilën e gjeni bashkëlidhur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2185/3 Prot.

Tiranë, më 18.5.2020

Lënda: Kthim përgjigje

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, nr. 371, 1005, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 911/4 prot., datë 23.4.2020 me lëndë "Kërkesë për përgjigje shteruese", ju bëjmë me dije si vijon:


Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në zbatim të pikës 7, të nenit 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", respekton lirinë akademike, autonominë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të institucioneve të arsimit të lartë. Zbatimi i përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, realizohet nga strukturat kompetente pranë IAL-së, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara për secilin organ individual apo kolegjial.


Universiteti i Mjekësisë Tiranë, gëzon të gjitha kapacitetet administrative, vendimmarrëse dhe profesionale për të realizuar zbatimin e detyrave funksionale sipas legjislacionit në fuqi. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e ka bërë me dije qëndrimin e saj me shkresën nr. 2185/1 prot., datë 22.4.2020, të cilën e gjeni bashkëlidhur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MEZAJKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË
DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Nr. 9962/..... Prot.

Tiranë më...16.6.....2020

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. ANDI MAHILA, ADMINISTRATOR
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Adresa: Rruga e Durrësit, Tiranë

Për dijeni: BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË

TIRANË

Në përgjigje të Tuajës nr.908/5 Prot, datë 01.06.2020 "Kërkesë për inspektim financiar publik", protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 9962 Prot, datë 02.06.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ju bëjmë me dije se:

Shkresa sa më lart cituar është adresuar nga ana e autoritetit tim pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik.

Bazuar në opinionin e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, në Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në vlerësim të ankesës së adresuar, sa më lart cituar, në kushtet kur Informacioni i paraqitur nuk identifikon qartë faktet që ngrenë dyshimin për ekzistencën e elementëve të keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit, kërkoj që:

1. Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucionit që mbulon fushën e përgjegjësisë, të UMT Tiranë, të marrë masa për kryerjen e një auditimi/monitorimi lidhur me problematikat e pretenduara në shkresën nr.908/5, datë 01.06.2020 (në referencë të nenit 7, germa "e" dhe "ë" të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë").
- Në rastet se nga auditimi i kryer/monitorimi do të konstatohen parregullsi që çojnë në keqmenaxhim të rëndë financiar, vjedhje, mashtrim, shkatërrim të pronës, shpërdorim të detyrës apo korrupsion, të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Nëpunësit të Parë Autorizues, ku të jenë

shpjeguar qartë proceset e gjurmës së auditimit/monitorimit së bashku me fotokopje të dokumentacionit justifikues të këtyre proceseve, si dhe;


2. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, strukturat përgjegjëse, si dhe Bordi Drejtues të marrë masa të menjëhershme për miratimin e buxhetit të institucionit (treguesit e buxhetit) , për vitin 2020, në zbatim dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Me respekt,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Arian Kraja





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 8700 / Prot.

Tiranë, më 8.6.2020

Lënda: Kthim përgjigje

SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë

Për dijeni:

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Adresa: Rruga e Durrësit, Tiranë

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

Adresa: Rruga e Sermendin Said Toptani, Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj, ardhur me shkresën nr.200/16, datë 26.05.2020, vlerësojmë se:

Buxheti i një institucioni publik apo jo publik, përfaqëson një nga shtyllat kryesore të ekzistencës së çdo institucioni. Për rrjedhojë, mosmiratimi i programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm, ku pasqyrohen objektivat e politikës së institucionit dhe burimet e financimit të këtyre objektivave, çënon funksionimin e këtij institucioni.

Për më tepër, theksojmë se mungesa e miratimit të buxhetit të institucionit, përçjell një risk të lartë në menaxhimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike.

Lidhur me problematikën e evidentuar mbi realizimin e procesit të prokurimeve pas datës 15 tetor të vitit të mëparshëm buxhetor, vlerësojmë që ky konstatim duhet të analizohet nga strukturat përkatëse audituese për të konkluduar nëse kemi të bëjmë me shkelje të legjislacionit përkatës, të vakumit ligjor apo të një interpretimi ligjor, me qëllim unifikimin e trajtimit të këtij rasti në këtë institucion krahasuar dhe me praktikën e mëparshme por dhe me institucionet homologe.

Mbështetur në sa më sipër, sugjerojmë procedimin e menjëhershëm të miratimit të buxhetit të institucionit, duke e ndarë atë nga problematika e konstatuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Arian Kraja



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë web: www.financa.gov.al Email: info@financa.gov.al